VENDIM

Nr.610, datë 20.10.2021

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të promovojë bashkëpunimin ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen.

3. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Shqyrton, ndjek dhe trajton ankesat administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre;

b) Promovon transparencën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asiston sipërmarrjen në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore të lidhura me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, kundrejt institucioneve publike;

c) Ndërmjetëson komunikimin e sipërmarrjes me institucionet publike për zbatimin e kontratave, si dhe zhvillon mekanizma të zgjidhjes paraprake të mosmarrëveshjeve midis tyre;

ç) Inkurajon zhvillimin e partneritetit dhe të komunikimit ndërjmet institucioneve publike dhe sipërmarrjeve, si dhe organizatave përfaqësuese të tyre;

d) Identifikon pengesat e biznesit në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe formulon strategjitë e ndërhyrjes për reduktimin e barrierave administrative.

dh)Angazhohet në monitorimin e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen;

e) Propozon mekanizma institucionalë/ndërinstitucionalë në funksion të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen.

4. Me qëllim realizimin e veprimtarisë si më sipër, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes:

a) përpunon dhe propozon përmirësimet e nevojshme funksionale, për platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre, si dhe për regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes të cilit monitoron procesin ndërinstitucional dhe i raporton Kryeministrit çdo fillim muaji;

b) krijon rregulloren e procedurës së brendshme, e cila detajon procedurën e:

i. regjistrimit dhe të pranimit të ankesave, sipas kritereve të përcaktuara në rregullore;

ii. komunikimit dhe të investigimit të çështjeve të pranuara me institucionet e lidhura publike;

iii. mbledhjes së evidencave dhe të informacionit të nevojshëm nga institucione të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike dhe/ose personave të tretë;

iv. komunikimit ndërmjet institucioneve publike dhe të sipërmarrjes që ka kryer ankimimin;

v. raportimit dhe publikimit të statusit të ankesave të trajtuara.

5. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes trajton të gjitha çështjet, përveç çështjeve, për të cilat është hapur një proces gjyqësor dhe/ose ka një vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Vendimi nr.511, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes", shfuqizohet.

7. Ngarkohet ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama